



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.120/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti -kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtar si dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, duke vepruar sipas Aktgjykimit me numër A.nr.1336/20, të datës 20.07.2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.120/2020 të datës 14.04.2020 të parashtruar nga ankuesi me adresë kundër organit të punësimit/Administrata Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike "transfer", duke vepruar në pajtim me nenin me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 03.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.120/2020 të datës 14.04.2020, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi është i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës, sipas Akt emërimit me numër 02/135/09 të datës 05.05.2017 në pozitën Drejtor Rajonal në Departamentin Shtylla Funksionale Operacionet në Ferizaj Administratën Tatimore të Kosovës. Me datën 03.02.2020 përmes e-mailit zyrtar është njoftuar nga Zyrtarja e lartë e personelit të ATK-së, lidhur me njoftimin mbi ri caktimin e tij nga pozita e Drejtorit Rajonal në Ferizaj në atë të Drejtorit Rajonal në Prizreni 2. Ndërsa me datën 03.02.2020, Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës ka nxjerrë Vendimin Nr.Prot.83 sipas të cilit është ri caktuar nga pozita e Drejtorit Rajonal në Ferizaj në atë të Drejtorit Rajonal në Prizreni 2.

I pakënaqur me ri caktimin e tij në pozitën e Drejtorit Rajonal në Prizreni 2, ankuesi me datën 21.02.2020, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 11-06-868 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me datën 11.03.2020 ka nxjerrë Vendimin Nr.21 sipas të

cilit e ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar dhe ka lënë në fuqi Vendimin Nr.Prot.11/83 të datës 03.02.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm në Administratën Tatimore të Kosovës.

I pakënaqur me vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me datën 14.04.2020 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 739/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 17.04.2020 përmes e-mailit zyrtar, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Administratën Tatimore të Kosovës. Këshilli, me datën 17.04.2020, ka pranuar përgjigjen në ankesë të ankuesit së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri me datën 08.10.2020, ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa me datën 11.06.2020, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës, e ka udhëzuar të njëjtin se mund të ndjek procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloj procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera, duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me datën 20.07.2022, ka nxjerrë Aktgjykimin me numër A.nr.1336/20, me ç'rast i njëjti në Këshill është pranuar me datën 22.07.2022, sipas të cilit ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 11.06.2020, duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankuesit të datës 14.04.2020.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me Nr.Prot:739/2020 të datës 14.04.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Nr.Prot.83 të datës 03.02.2020 lidhur me ricaktimin e ankuesit në pozitën si Drejtor Rajonal nga Ferizaj në Prizreni 2; Vendimin Nr.Prot.21 të datës 11.03.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Akt emërimit e ankuesit me Nr.Prot.02/135/09 të datës 05.05.2017; E-mailin zyrtar të datës 05.02.2020 lidhur me ri caktimin e ankuesit; E-mailin zyrtar të datës 03.02.2020 lidhur me njoftimin mbi ri caktim; Kërkesën për përgjigje në ankesë përmes e-mailit zyrtar të datës 17.04.2020 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 17.04.2020 nga Administrata Tatimore e Kosovës së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Ankesën e ankuesit Nr.Prot.11-06-868 të datës 21.02.2020 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimin Nr.Prot.24 të datës 27.01.2021 nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së; Kërkesën për informata zyrtare përmes e-mailit zyrtar të datës 26.07.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen e datës 26.07.2022 përmes e-mailit zyrtar nga Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës; Aktgjykimin A.nr.1336/2020 të datës 20.07.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara si nga ankuesi ashtu edhe nga organi i punësimit, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit është bërë i pamundur, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka analizuar Vendimin Nr.Prot.24 të datës 27.01.2021 lidhur me ri caktimin e ankuesit në pozitën si Drejtor Rajonal në Drejtorinë Rajonale në Ferizaj dhe rikthimin në pozitën e mëparshme, me datën 26.07.2022 përmes e-mailit zyrtar ka kërkuar informata zyrtare prej Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës lidhur me atë se "A janë rikthyer drejtorët rajonal (në rastin konkret ankuesi) në pozitën e mëparshme pas ricaktimeve" dhe në përgjigjen zyrtare të datës përmes e-mailit zyrtar dhënë për Këshillin, kjo e fundit ka deklaruar se: "Bazuar në kërkesën tuaj, ju njoftoj se të gjithë drejtorët rajonal janë rikthyer në pozitën e tyre, e në rastin konkret edhe ankuesi si Drejtor i Drejtorisë Rajonale në Ferizaj". Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në bazë të kësaj rrethane konstaton se objekti i shqyrtimit të ankesës së ankuesit është bërë i pamundur ose i kotë, pasi që ankuesi me Vendimin Nr.Prot.24 të datës 27.01.2021 është ri caktuar në pozitën e mëparshme ku ka qenë si Drejtor i Rajonal në Drejtorinë Rajonale në Ferizaj, e krejt kjo në pajtim me nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "**Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë**", andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka vendosur për përfundim të procedimit administrativ në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.120/2020, datë 03/08/2022.

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.

